

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më:	01.03	20.21
Primljeni:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtoja Dodatak
15 - 500	11700	

## Informatë nga Drejtoriati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale rreth situatës me Pandeminë Covid-19 në Komunën e Lipjanit

### HYRJE

Viti 2020 ishte vit sfidues, ishte vit jo i zakonshëm për vendin tonë dhe për gjithë botën, sepse botës i shpalli luftë natyra, armiku ishte biologjik dhe quhej virusi Corona i cili na sfidoi gjatë tërë vitit që lam pas e që fatkeqësisht vazhdon edhe sot e kësaj dite!

Sëmundja (COVID-19) është një sëmundje ngjitëse e shkaktuar nga sindroma e rëndë akute e fryshtës (SARS-CoV-2) dhe që shkakton edhe vdekje - fatalitet!

Me përhapjen e shpejt të këtij virusigati në gjithë botën edhe tek ne si shtet, ne si komunë filluam përgaditjet qysh në muajin Shkurt kur patëm thirrje nga MSH dhe Instituti për përgaditjen dhe marrjen e masave për parandalim ndaj infeksionit.

Fillmisht është bërë furnizimi me maska dhe dezinfektues, për stafin shëndetësor, pajisjet mbrojtëse – veshjet speciale, me maska mbrojtëse dhe me termometër për matjen e temperatures. Me kërkesen e MSH dhe IKSHPK ekipa mjekësore e QKMF-së ka qenë e gatshme për 24 orë kujdestari në airoport, në pritjen e pasagjerëve për të identifikuar rastet e dyshimta, praktikë që vazhdoi gjatë tërë vitit.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë është trajnuar personeli shëndetësor në raport me individet e infektuar, pasi që virusi ishte i ri dhe i panjohur si dhe janë shpërndarë poster dhe njoftime të ndryshme lidhur me pasojat e virusit në të gjitha institucionet shëndetësore dhe arsimore.

Komuna e Lipjanit me kërkesën e Institutit ka përgaditur hapësiren për karantinë në ish objektin e Pulmologjisë

Fillimi i muajit Mars 2020 në nivel vendi është shpallur gjendja emergjente shëndetësore.

Komuna e Lipjanit qysh nga ditët e para të ballafaqimit me pandeminë Covid -19, ka krijuar shtabin emergjent të cilin e ka udhëhequr Kryetari i Komunës Imri Ahmeti.

Ky shtab ka ndërmarrë të gjitha veprimet e lejuara konform udhëzimeve që kanë dalur nga institucionet qendrore dhe rekomandimet e IKSHPK-së. Njëherit ky shtab ka aktivizuar numrin emergjent (pa pagesë), për t'u mundësuar qytetarëve të

drejtojnë kërkesat e tyre direkt në shtabin emergjent, po ashtu është instaluar komunikimi elektronik me viber për të komunikuar dhe konsulutar me pacientët – qytetarët nga shtëpia. Po ashtu ky shtab ka aktivizuar edhe sektorin për ndihma të familjeve në nevojë dhe sektorët tjerë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës për implementimin e vendimeve që rezultuan nga periudha e pandemisë Covid-19.

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan janë marr masa që nga fillimi në menaxhimin e pandemisë, janë bërë dezinfektime të hapësirave publike dhe rrugëve kryesore të qytetit, është vendosur tuneli dezinfektues pranë QKMF-së, janë vendosur dezinfektues statik në objektet e institucioneve publike.

Më datë 19.03.2020 është paraqitur rasti i parë i infektuar me COVID 19 në komunën e Lipjanit gjegjësisht në fshatin Janjevë.

Pas identifikimit të rastit të parë në Janjevë, me vendim të Institutit Janjeva hyri në karantinë sipas protokollit që zbatohej prej nivelit qendror. Me këtë rast u shtuan edhe masat dhe aktivitetet tona në nivel të Komunës nga Shtabi Emergjent për furnizimin me ushqim të banorëve, por edhe shërbimet shëndetësore shtesë në Janjevë 12 orë pune në QMF së bashku me autambulancën 12 orë në ditë për nevoja të qytetarëve të Janjevës.

Komuna e Lipjanit bashkë me Kompaninë e Pastrimit ka vazhduar dezinfektimin e rrugëve të qytetit dhetshatit Janjevë si zonë e karantinuar dhe disa lokalitete tjera.

**Me 30 marsme vendim të Qeverisëhpallet gjendja e Emergjencës Shëndetësore**, vendimkyicili reduktoi shumë aktivitete, u reduktua orari ilëvizjeve dhe hyrje - daljet në disa komuna. Me këtë vendim u liruan edhe punëtorët – kategoria e cenuar(të moshuarit, ata me sëmundje kronike, shatëzënat etj.

Duke menaxhuar Pandeminë, nuk u harrrua për asnjë moment kategoria sociale.

Komuna e Lipjanit ka ndërmarrë edhe një varg veprimesh të tjera në menaxhimin e kësaj situate.

Me kërkesën e Kryetarit Imri Ahmeti, Kuvendi i Komunës ka miratuar propozim vendimet për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 170,000.00 për ndihma të familjeve në nevojë dhe nevojave të tjera të menaxhimit të situatës emergjente nga pandemia Covid-19.

Po ashtu me qëllim të krijimit të lehtësirave financiare për shkak të pandemisë që ka rezultuar ne pezullimin e shumë veprimtarive punuese Komuna e Lipjanit ka marrë vendim për lirimin nga pagesa e taksave dhe qerasë komunale.

Që nga dita e mbylljes së çerdhes publike për arsyet e shfaqjes së pandemisë, Komuna e Lipjanit ka liruar nga pagesa (participimi) të gjithë prindërit që kanë të regjistruar fëmijët e tyre për qëndrim ditor në këtë çerdhe për vitin 2020.

Pastaj, me qëllim të përkrahjes së fëmijëve pa asnjërin prind në kohë Pandemie Kryetari i Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti, ka marrë vendim që të ju dal në ndihmë edhe 23 fëmijëve pa përkujdesje prindore (pa asnjërin prind) dhe një familje strehuese me nga 300 euro.

Komuna e Lipjanit në kohë Pandemie ka ndihmuar qytetarët e Komunës së Lipjanit me rreth 6 mijë pakonjekte ushqimore dhe higjenike.

Komuna Lipjanit gjatë kësaj koheka ndihmuar qytetarët edhe përmes bashkëpunimeve me donator të ndryshëm të bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale, Kryqin e Kuq, Bashkësinë Islame në Lipjan, AQH, Zyren e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Shoqata “Jetimat e Ballkanit”, Fondacioni Labinot Tahiri, Qatar Charity, Emiratet e Bahskuara Arabe, ROMACTED, Metkos PHARM, Made Kos, UNICEF, UNDP, USAID, KFORI (Turk LMT), World Vision, Elkos Group, Viva Fresh dhe Buqaj, Radio Star, Urban Center, Isamete Krasniqi Bylgjyzare Rrahmani.

*Sipas hulumtimit dhe raportit të Institutit GAP “Ndikimi i Pandemisë COVID19 në pushtetin lokal”, Komuna e Lipjanit është renditur e dyta në nivel vendi që i ka zbatuar masat, dhe ka ndikuar në frenimin e pandemisë Covid-19.*

**Janë dhënë gjitha shërbimet shëndetësore**, gjithmonë duke respektuar masat preventive sipas MSH dhe rekomandimeve të IKSHPK!.

Nga shërbimet e rëndomta nuk ka pas as kufizim të tyre përpos vaksinimit të fëmijëve i cili u pezulluame vendim të Institutit dhe MSH (15 mars) si dhe vizitat për nëna dhe fëmijë deri në 3 vjet për të vazhduar prap pastaj në muajin MAJ gjithashu me vendim të IKSHPKPo ashtu në Sektorin e Stomatologjisë me vendimin e MSH, janëpezulluar shërbimet e rregullta pos atyre me natyrë.

### **Shërbime tjera janë dhënë të gjitha me kapacitetet të plotë**

Vizita në qendrën e Azilit, në Magurë janë kryer sipas kërkesave.

Shërbimi i **Kujdesit paliativ** gjithashtu nuk ka pauzuar asnjë ditë të javës.

Autokombi dhe autoambulanca për pacientët në **dializë** ka shërbyer gjithashtu çdo ditë të javës.

**Këshillimorja** për pësonat me Diabet dhe HTA ka funksionuar çdo ditë të punës. Dezinfektimi i hapësirave të institucioneve shëndetësore ishte i rregullt dhe u bë rutinë.

**Varësisht prej trendit të rasteve pozitive, vendimeve dhe zhvillimeve të ndryshme nga niveli qendror, edhe ne kemi vazhduar duke respektuar ato**

Fillmisht kur numri i rasteve pozitive në Covid 19 ishte më i vogël (muaji mars e prill), ne kishim liruar ish objektin e Pulmologjisë me 3 shtretër për trajtimin e pacientëve Covid pozitiv.

Me propozimin e Shtabit Emergjentë **udhëhequr nga kryetari i komunës**, funksionalizuam u **autoambulancën COVID** e cila do të ofronte shërbime shëndetësore edhe në shtëpi.

Me rritjen e numrit të rasteve pozitive kemi liruar pastaj në **tërësi objektin e Maternitetit** vetëm për pacientët Covid Pozitiv me një hapsirë të mjaftueshme dhe me shtretër të mjaftueshëm (12 shtretër) i cili deri më sot ka përmbushur nevojat e gjithë atyre që kanë ardhur për vizitë dhe trajtim mjekësor, shërbimet janë kryer nga ekipa mjekësore me një mjek dhetri infermiere cdo ditë të javës.

Shërbimet kanë vazhduar edhe në punkte QMF dhe AMF në orar të caktuar, pas furnizimit me pompa për dezinfektim qysh në mujin Mars ne kemi vazhduar deri më sot me dezinfektimin e hapësirave në gjitha Institucionet Shëndetësore dhe autoambulancat për të vazhduar në ditët dhe muajt në vazhdim përgjatë tërë vitit e që do të vazhdojmë edhe në të ardhmenë edhe kur ska pandemi.

## **PANDEMIA NDËR MUAJ** **(Mars, Prill, Maj dhe Qershori)**

*Prej 19 marsit nga rasti parë deri në gjysmën e dytë të prillit ishin gjithsejt 20 raste pozitive, për të vazhduar pastaj me zero raste deri me 10 qershor kur filluan*

*praprastet tjera të rejaderi më 30 qershori ishin gjithsejt 40 raste pozitive gjithsejtë, 17 të shëruar dhe 24 aktiv.*

#### **Pandemia gjatë muajit Korrik:**

*Gjatë këtij muaji ishte numri më i madh i rasteve pozitive me Covid-19, qysh prej fillimit të Pandemisë. Gjithsejtë ishin 161 raste positive, 102 të shëruar dhe jo zyrtarisht 3 të vdekur.*

*Numri i rasteve pozitive u rrit në gjithë vendin! Edhe Komuna jonë nuk u tregua rezistente, pavarsisht respektimit të masave të MSH dhe rekomandimeve të Institutit!*

*Eshtë ndarë pjesë e veqantë në objektin QKMF – së me tri dhoma me gjashtë shtretër, për trajtimin ditor të pacientëve të infektuar, marrjen e infuzioneve dhe sipas nevojës Oxygeno-terapi. Ndërsa në punkte është ndarë orar i veqantë për pacientët e prekur, për vizitë, trajtim dhe marrjen e terapisë- infuzioneve apo Oxyegoterapi*

#### **Pandemia gjatë muajit Gusht**

*Numri i rasteve të reja pozitive gjatë këtij muaji ishte 127 gjithsejt.*

#### **Pandemia gjatë muajit Shtator:**

*Nga 255 qytetarë të testuar në SARS-COV2, 57 rezultuan pozitiv, ndërsa 115 të shëruar..*

#### **Pandemia gjatë muajit Tetor:**

*Nga 375 qytetarë të testuar, 77 gjithsejt rezultuan pozitiv, ndërsa vetëm 26 të shëruar.*

#### **Pandemia gjatë muajit Nëntor:**

*Pandemia mori përpjetën shumë. Nga 913 qytetarë të testuar në SARS-COV2, 553 nga këta rezultuan pozitiv dhe 134 të shëruar. Me këtë rast, varësisht trendit të rritjes së rasteve ne liruam objektin e Maternitetit në tërësi, me një hapsirë të mjaftueshme dhe një numër të konsiderueshëm të shtretërëve (12 shtretër), për t'i plotësuar edhe me 13 shtretër të ri elektrik të cilët i kemi vendosur në Maternitet dhe Qmf tjera!*

*Gjithashtu edhe në punkte ka vazhduar trajtimi dhe shërbimi mjekësor në orar të veqantë të përcaktuar më herët (16:00 – 18:00).*

**Pandemia gjatë muajit Dhjetor:**

*Nga 956 qytetarë të testuar në SARS-COV2, 373 rezultuan pozitiv 551 të shëruar dhe 4 të vdekur!*

*Atëherë, prej fillimit të Pandemisë e deri me datë 31.12.2020, bazuar gjithnjë në rrezultatet e rregullta të IKSHPK, në Komunën Lipjanit tonë janë identifikuar 1388 raste pozitive, 1069 të shëruar, 26 të vdekur dhe 293 raste aktive!*

*Staf shëndetësor dhe staf mbështetës i prekur me Covid -19 prej fillimit deri në fund të vitit, janë: 15 mjek (4 Stomatolog, 1 Gjinekolog, 1 Radiolog dhe 9 mjek Familjar dhe të përgjithshëm).*

*Nga staf i mesëm infermier 27 gjithsejt, nga staf teknik 5 punëtorë dhe administratë 2 punëtorë!*

*Ndësa gjithsejt gjatë tërë vitit qysh prej fillimit të Pandemisë janë dhënë 8217 infusione në QKMF, QMF dhe AMF, duke mos llogaritur numrin e infusioneve që janë dhënë në shtëpi!*

*Stafi prekur në QPS, gjithsejt 4, ndërsa në Shtëpinë e Komunitetit asnjë rast!*

Ndonëse viti 2020 shënon sfidën e jashtëzakonshme të paparashikuar me Pandeminë COVID 19, Komuna e Lipjanit përkundër të gjitha vështirësive të shfaqura i ka kushtuar prioritet Shëndetit Publik e gjithashtu është përkushtuar në vazhdimësi në realizimin e projekteve për përmirësimin e kushteve dhe krijimin e hapësirave më të mira, ofrimin e shërbimeve sa më të qasshme dhe sa më cilësore si dhe sigurimin e apraraturave moderne:

- *Furnizimi me 16 shtretër elektrik, kryesisht për shërbimet e infusioneve, në Maternitet, Urgjencë dhe QKMF*
- *Furnizimi me dyshekët për shtretër, me jastëk dhe mbulesa për shtretër të pacientëve*
- *Furnizimi me uniforma për stafin mjekësor dhe stafin mbështetës*
- *Furnizimi me materiale për shërbimet shëndetësore të integruala nga AQH*
- *Furnizimi mepajisje mbrojtëse personale për stafin vazhdimisht*
- *Është shpërndarë sapun i lëngshëm në të gjitha ordinancat për dezinfektimin e duarëve, po ashtu edhe me letër për dispanzer, vazhdimisht*

- *Jemi furnizuar disponzer për letër dhe disponzer për dezinfektues*
- *Jemi furnizuar me pompa për dezinfektim dhe janë dezinfektuar hapësirat vazhdimisht*
- *Jemi furnizuar me tunelin dezinfektues*
- *Jemi furnizuar përmes kontrates kornizë me barna dhe material medicinal për nevojat e QKMF-së.*
- *Jemi furnizuar me pajisjet mjekësore sipas kontratës dy vjeqare: 9 aparate për prodhimin e Oksigenit, aparate këto shumë të domosdoshme në kohën e Pandemisë dhe janë shpërndarë në të gjitha Institucionet Shëndetësore.*
- *Jemi furnizuar me aparate të EKG -së, si dhe aparate defibrillator dhe janë shpërndarë në gjitha QMF- të*
- *Jemi furnizuar me numëruesh hematologjik dhe banjo ujore për laboratore dhe janë shpërndarë në gjitha QMF - të*
- *Jemi furnizuar me Aspirator kirurgjik*
- *Jemi furnizuar me bombola të Oxygenit dhe janë shpërndarë në punkte*

## DONACIONET NË SHËNDETËSI

- Aparatin që prodhon O2 në kapacitet prej 10 litrave nga Ministra e Shëndetësisë
- Donacione me mjete mbrojtëse nga KFOR-I, FSK-JA, BIK-u, qytetarë, operator, OJQ etj.
- Donacion nga UNICEF-i automjetin **Ford** për shërbimet shëndetësore, dhe shërbimin për nana dhe fëmijë deri në 3 vjet
- Donacion nga FSK, otoman për AMF-Dobrajë
- Donacion nga AQH- mjete mbrojtëse personale për stafin
- Donacion nga MADEKOS në vlerë prej 2.000 ( dy mijë ) euro, maska, dorëza,dezinfektues, syze, mantila njëpërdorimëshe etj
- Donacion me barna nga kompania farmaceutike Omega Pharm
- Donacion me maska mbrojtëse nga disa rrobaqepëse të Komunës
- Racione ushqimore për stafin nga asalistët në Komunë. Etj

## SHËRBIMET SOCIALE GJATË PANDEMISË COVID 19

Shërbimet sociale nga 12 Mars 2020, dhe për gjatë tërë kësaj periudhe raportuese, mbesin si hallka më e rëndësishme e përkrahjes së popullatës në nevojë në Komunën e Lipjanit, si shërbime të rëndësise së veqantë dhe jetike për popullatën dhe në këtë rast siq është Pandemia Covid 19.

Pandaj nga kjo retrospektivë e punës sociale si Institucion Komunal për masat e ndërmarrura në zbatim të vendimeve për ruajtje të shëndetit publik nga Covid 19, si dhe në ofrim të shërbimeve emergjente, japim raportin si në vijim:

- QPS fillimisht zbatoi vendimet për ruajtjen e shëndetit publik, dhe në ofrim të shërbimeve sociale dhe emergjente, si staf esencial gjatë periudhës së Pandemisë Covid 19.
- Vendimi nga zyra e Kryetarit Nr. 500-16167, të datës 12.03.2020, lidhur me masat preventive të Pandemisë së Covid 19 siq janë: (dezinfektimi i hapsirave në vendin e punës)
- Respektimi i urdhëresës Nr.034-16103 i datës 12.03.2020 nga zyra e Kryetarit për pezullimin e takimeve me palë, përvèq atyre me natyrë urgjente.
- Respektimi lëvizjes së lirë të zyrtarëve të përfshirë në listën esenciale të zyrtarëve për funksionim të shërbimeve, përfshirë edhe QPS si staf esencial në Komunën e Lipjanit, konform vendimit të Qeverisë të datës 23.03.2020, në mbrojtje dhe ofrim të shërbimeve për qytetarët në nevojë.
- Zbatimin e Vendimit për masën 15, të Pakos Emergjente Fiskale Nr. 35/2020 të datës 16.04.2020 si dhe zbatim i Vendimit Nr. 551-16897 dt.16. 04.2020 për menaxhimin të Masës -15 (**asistencë mujore Prill-Qershori/2020 në vlerë 130€**) për familjet që nuk kanë asnje të hyrë financiare
- Zbatimi i qarkorës informative nga MSH për pjesëmarrje të punonjësëve social në trajtimin e viktimateve të karantinuara në Qendrën e Studentëve, filluar nga 27.04.2020-30.05.2020, si dhe zbatimi i Vendimin Qeveritar Nr. 02/06 të datës 17.06.2020 për aprovimin e kërkesës së MSH në respektim të manualit për mbrojtje nga përhapja e Virusit Covid-19.

- Zbatim i Udhëzuesit për Menaxhim të rasteve me qëllim të mbrojtjes së fëmiut gjatë Pandemisë me Covid-19 në Kosovë, adresuar nga organizata nderkombëtare “Terre des hommes”.
- Respektimi i Vendimit Nr.01/39, dt.01.11.2020 për pezullimin e procedurave të ri-aplikimit në afat të pacaktuar për familjet në Skemën e Ndihmave Sociale.
- Të gjitha këto Vendime, urdhëresa, udhëzues dhe katalogët u respektuan dhe ishin në zbatim gjatë gjithë periudhës raportuese nga QPS, përkundër faktit të angazhimit të stafit në shërbime emergjente, siq është pako 15 nëpër komisione në kuadër të shtabit emergjent dhe në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje të karantinuara në Qendrën e Studentëve-Prishtinë, mbajtjes së kujdestarisë 24/7 ditë në javë, dhe në shpërndarje të pakove ushqimore dhe higjenike në terren etj.
- Gjatë kësaj periudhe raportuese përkundër faktit që është sugjeruar të punojmë me staf të reduktuar, kemi punuar me staf mbi 70%, për shkak të vëllimit të punëve si rrjedhojë e Masës 15, të Pakos Emergjente Fiskale, krijuar nga virusi COVID 19.
- Ndërsa nga data 28.05.2020 me staf të kompletuar, me pjesëmarrje edhe të atyre që janë liruar sipas vendimit të Qeverisë, sëmundje kronike, prind me fëmijë, gra shtatzëna.

QPS përgjat këtij viti ka realizuar këto aktivitete, bazuar në Vendimin e Qeverisë Nr. 35/2020, të datës 16.04.2020, për Masën 15, të Pakos Emergjente Fiskale janë realizuar aktivitete në zbatim të këtij vendimi, për zbatim të Masës 15, pastaj në:

1. Menaxhim dhe administrimit të skemës së ndihmave sociale për familjet në nevojë, për mbëshqetje me A.S. administruar, menaxhuar dhe realizuar nga dy pagesa të asitencës sociale në muaj, për gjashtë muaj rrjesht (Mars-Qershori dhe Tetor-Nëntori/2020)
2. Ofrim në përkujdesje sociale, përfshirë mbështetjen e familjeve me pako higjenike dhe sanitare.
3. Realizim të kujdestarisë për intervenim në raste 24/7 ditë në javë.
4. Zbatim të Masës 15, të Pakos Emergjente Fiskale, sipas Vendimit 35-2020, dt.16.04.2020 nga Ministria e Financave dhe Transfereve, obliguar komunën për zbatim të kësaj Mase 15, përmes QPS-ës.

5. Menaxhim të rasteve të dhunës në familje.
6. Realizim të kontakteve prind-fëmijë për nëntë familje, përmes platformës online.
7. Pjesëmarrje e katër zyrtarëve të QPS-ës në shpërndarje të ndihmave, organizuar nga Shtabi Emergjent.
- 8. Janë marrur në Konsideratë të gjitha palët që kanë kërkuar ndihmë për asistencë dhe pakos ushqimore në QPS.**
9. QPS ka ndërmarr të gjitha masat preventive edhe për popullatën me AS-le, qka realisht janë hartuar nga SH.S dhe A.S dhjetëra regjistra për të ndihmuar familjet me pakos ushqimore dhe higjennike. Në këto **regjistra janë përfshirë qindra familje**.
10. Donacione nga disa biznese dhe afarist si: “7Vllezërit”, BIK-u, “Shoqata Bereqeti” të cilat i kanë dal në ndihmë dhjetëra familjeve me bukë, si dhe përfshierja e shpërndarjes së bukës për 26 familje në Lipjan, dhe në banimin social-kolektiv në Magurë për 10 ditë.
11. Pastaj Kryqi i Kuq në Lipjan, icili u ka dalurnë ndihmë me ushqim familjeve në zonën e karantinuar në Janjevë duke shperdarë 150 pakos.
12. Gjitashtu 212 familje i janë raportuar Shtabit Emergjent për shpërndarje të pakove ushqimore
13. Bashkepunimi me World -Vizion, së cilës i është ofruar regjistri me 20 familje në nevojë për t'i ndihmuar me pakos familjare.
14. Jane ofruar regjistrat e prindërve vetushqyes për të i'u ofruar pakos ushqimore nga donator të ndryshëm.
15. 04.2020- 28.05.2020- Kujdestari për viktimat e dhunës në karantinë, asistuar në Qendrën e Studentave-Prishtinë. Me kerkesë të DPSF-MSH.
16. Janë shpërndarë 258 pakos me material didaktikë të dhuruara nga UNICEF në bashkëpunim me MPMS. Pakotë janë dedikuar për fëmijë 0 deri 6 vjeç, të familjeve shfrytëzuese të ndihmës sociale, të përzgjedhura nga ana e DPSF – MPMS.
17. Janë shpërndarë 90 kupona për 90 familje ne vlerë prej 60,70 dhe 80 euro nga UNDP dhe “INTEREX” it
18. Ndërsa janë pranuar edhe 55 kuponë të rinjë për 55 familje të përzgjedhura prapë nga të dy shërbimet e QPS-së. Gjithsej 145 familje janë ndihmuar me kuponë. Etj.

**Totali i përfituesëve nga skemat e zbatuara në QPS gjatë periudhës së Pandemisë Covid-19**

Skemat.	Asistencë sociale Janar – Dhjetor	Masa - 15	Strehim familjar	Skema PAK
<b>Numri i përfituesve</b>	<b>1210–1323</b>	<b>2447</b>	<b>21</b>	<b>92</b>
<b>Totali në euro</b>	<b>2.493.175.5</b>	<b>500.370.00</b>	<b>20.600.00</b>	<b>106.100.00</b>

Raporti është i bazuar dhe i dokumentuar në raportet e rregullta ditore, javore dhe mujore, shifrat e përsonave të infektuar, të shëruar janë ekskluzivisht nga rezultatet e rregullta të IKSHPK- së.

Me respekt!

**Dr.Merita H. Bytyqi**

Drejtoreshë e DSHPS-së